



## KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Shërbimi për Punë të Kuvendit

01 Nr 06- 5066 /14

Klinë, më 25. 11. 2014

## EKSTRAKT - PROCESVERBALI

Nga mbledhja e X-të e radhës e Kuvendit të Komunës së Klinës, e mbajtur më datën 25. 11. 2014, në sallën e Kuvendit me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje ishin prezent:

**Kryesuesi i Kuvendit dr. Haxhi Ibishi dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës.**

Pjesëmarrës të tjerë ishin: Nënkyetari i Komunës z. Enver Berisha, drejtorët e drejtive të Komunës, përfaqësues të OSBE-së, të Zyrës Ligjore, të Policisë së Kosovës, të KFOR-it, OJQ-të, zyrtarja për informim, mediet, Asambleja e fëmijëve në krye me zyrtaren Komunale për të drejtat e fëmijëve znj. Atifete Bytyqi e tjerë.

Mbledhjen e hapi Dr. Haxhi Ibishi - kryesues i Kuvendit, i cili pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje dhe shtoi se sot i kemi të pranishëm asamblistët e fëmijëve, andaj ftoi kryetaren e kësaj asambleje që t'i drejtohet Kuvendit me një fjalë rasti.

Naile Kalludra - kryetare e Asamblesë së fëmijëve, pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë tha se kjo Asamble është themeluar në vitin 2004 dhe mbledhjet mbahen çdo muaj në sallën e Kuvendit të Komunës, rendi i ditës përgatitet në bashkëpunim me zyrtaren komunale për të Drejtat e fëmijëve, znj. Atifete Bytyqi. “Kjo Asamble e ka përkrahjen e Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit dhe institucioneve tjera komunale, pastaj të OSBE-së e tjerë”.

**Dr. Haxhi Ibishi, tha se tani i kthehem i rendit të ditës:**

**Prend Buzhala:** Shprehu shqetësimin e tij se tani në kohë paqeje po bëhet një spastrim etnik, gjegjësisht një “gjenocid i bardhë, ku popullata nga varfëria e skajshme e rrezikojnë edhe veten, edhe familjet e tyre për një jetë më të mirë, sepse po shohin se nuk kanë asnjë perspektivë në vendin e tyre.” Ky është rezultat i keqeverisje” shtoi anëtarë Buzhala dhe propozoi që në pikën e rendit, Të ditës të ndryshme, të jepet një sqarim nga Drejtoria e Kulturës se pse në këtë drejtori paguhet një punëtor që nuk është punëtor i kësaj drejtori, pse nuk ka zyrtar të rinisë dhe pse nuk ka ansambël muzikor?” - shtoi prof. Buzhala.

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha se në rekondimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, ju i keni paraqitur disa pyetje e kur ta shqyrtojmë atë rekondim do të përfshihen edhe këto pyetje që i bëtë sot për Drejtoren e Kulturës dhe shtoi se në pikën, Të ndryshme, duhet të debatojmë rreth reformimit të dy Komiteve obligative të Kuvendit me përfaqësim gjinor në bazë të Udhëzimit Administrativ dhe për këtë ne do ta mbajmë një mbledhje me shefat e Grupeve parlamentare.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës

Me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit u miratua ky

### R e n d i i d i t ë s:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit finansiar për periudhën janar-nëntor 2014,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës të Projekt-rregullores për transparencë në Komunën e Klinës dhe Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Komisionit komunal për të zhdukurit për zyrtarizimin Ditës së të zhdukurve-datën e 4 Prillit,
7. Njoftim me përgatitjen e caktimit te orarit kalendarik të punës së Kuvendit dhe komiteve dhe përgatitja e Planit të punës së Kuvendit dhe komiteve për vitin 2015 (për seancën e dhjetorit),
8. Të ndryshme.

**Pika e I-rë: Arsyetimi i mungesave.**

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha kam një arsyetim nga Avni Gashi, i cili gjendet në një trajnim.

**Pika e II-të: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar.**

Procesi i mbledhjes së kaluar u miratua unanimisht nga të pranishmit.

**Pika e II-të: Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së.**

**Dr. Haxhi Ibishi**, propozoi që në vend të preferencave të KPF-së të jenë rekondimet e KPF-se për Kuvend.

**Rekomandimet e KPF-së për Asamble u miratuan unanimisht nga anëtaret e Kuvendit.**

**Pika e IV-te: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit finansiar për përudhen janar-shtator 2014.**

**Ramiz Rrusta** – drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, tha se sot do të debatojmë për shpenzimet që janë bërë në këtë nëntëmujor. “Në mbledhjen e KPF-së është paraqitur kërkësë që të dorëzohet lista me emër dhe mbiemrë të përfituesve të subvencioneve. Unë këtë listë e kamë përgatitur dhe shërbimi do ta kopjojë dhe ta shpërndajë atë listë.

Shpenzimet në përudhen janar-shtator 2014 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar të vitit paraprak janë rritur për 11.62%; shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak janë rritur për 28.53%; shpenzimet për mallra dhe shërbime janë rritur për 5.71%; ndërsa shpenzimet për subvencione janë zvogëluar për 10.30%, e po ashtu edhe shpenzimet kapitale janë zvogëluar për 13.19%. Nga të hyrat e tatimit në pronë kemi rritje dhe besoj se deri në fund të vitit do të bëhet realizimi për 100%, mandej kemi një rritje nga gjobat në trafik dhe gjobat nga gjykata” shtoi drejtori Rrusta i cili më tutje theksoi se nuk ka tejkalim të shpenzimeve sic pretendojnë disa. “Unë edhe në mbledhjen e KPF-së kam thënë së drejtoritë që punojnë më shumë edhe shpenzojnë me shumë. Unë, shtoi ai, nuk po zgjati më shumë, ju këtë raport finansiar e keni para vetes dhe jam i gatshëm të përgjigjim pyetjeve tuaja që ju interesojnë”, sqaroi drejtori Rrusta.

**Arben Limanaj**, tha së në këtë raport finansiar për përudhen janar-shtator 2014, shihet së janë bërë shpenzime enorme, si në shpenzimet për karburante, për dreka e darka zyrtare, për mirëmbajtje të automjeteve e tjera.” Dhe, nëse i krahasojmë shpenzimet për gjashtëmujorin e parë të këtij viti shihet se për këta tre muajt e fundit shpenzimet janë 100% me të larta e në disa sfera edhe më shumë”, pohoi anëtari Limani.

**Skënder Merturi**, tha se fillimisht dua t’i bëj një pyetje drejtorit, se a është keqpërdorur buxheti i Komunës për fushatë elektorale dhe, në çfarë kriteresh jepen subvencionet? E, sa i përket shpenzimeve, po shihet se për këta tre muajt e fundit është bërë një punë e madhe, tani po del se janë dhënë para të buxhetit të Komunës për fushatë zgjedhore, e kjo nuk është e drejtë dhe është ndaluar me Ligj”, shtoi anëtari Merturi.

**Prend Buzhala**, tha se këto shpenzime që janë bërë janë tepër të larta. “Ju po e shihni së nga varfëria e skajshme qytetarët për çdo ditë ikin nga vendi ynë për të siguruar bukën për familjet e tyre e duke e rrezikuar edhe jetën”.

**Fadil Gashi**, tha së ne ende jemi duke paguar haraç të fushatës zgjedhore.” Më herët është identifikuar së Komuna ka subvencionuar Agjensionin Tatimor të Kosovës,

pra ATK-në, ndërsa ka indikacione së Komuna ka subvencionuar edhe bizneset private. Çka është edhe me keq, shtoi anëtari Gashi, se tek të hyrat vetanake ka rritje dhe për atë arsyesh zyrtarët komunalë duhet të shkojnë me shpesh në dreka e darka. Të hyrat nga donatorët nuk ka ato janë zero-zero, janë harxhuan 50 mijë euro për telefon, pastaj kemi obligime të mbeturë nga viti i kaluar e tjera. Unë kërkji që të na sillet lista e përfituesve të subvencioneve, e pasi që nuk kemi një Rregullore për ndarjen e tyre, bile së paku të debatojmë në Kuvend” theksoi anëtari Gashi.

**Ramiz Rrusta**, tha se po del që Arbeni qenka ekonomist i fortë. “Nuk ka subvencionim të firmave private dhe, nëse keni fakte përmua se më ka parë dikush gjatë fushatës me veturë zyrtare, urdhëroni e argumentojeni. Ndërsa, për pyetjen se si është e mundur që fushata bëhet me para të buxhetit, unë vetë po habitem nga kjo pyetje”, shtoi drejtori Rrusta.

**Fadil Gashi**, theksoi se unë mendoj se nuk është kjo logjikë se nëse bëhet shumë punë edhe duhet të këtë shumë shpenzime dhe se përfushatë elektorale të zgjedhjeve të kaluara ka pasur shpenzime nga buxheti i Komunës e tani po thua se aty ku punohet edhe shpenzohet.

**Arben Limanaj**, tha se nuk duhet të jesh shumë ekonomist për t'i parë shpenzimet enorme që janë bërë.

**Rasim Millaku** tha se në këtë raport janë ofruar të gjitha shpenzimet që janë bërë në këtë nëntëmuajor të këtij viti, dhe mendoj së kjo është transparente dhe shihet së Drejtoria e Bujqësisë ka shpenzuar me së paku.”Unë mendoj se në pikë të shkurtra ka tejkalim të shpenzimeve”, vlerësoi Millaku.

**Ndue Shabanaj**, tha se unë mendoj se duhet ta ndryshojmë qasjen pozitë-opozitë.”Ne duhet t'i analizojmë të hyrat vetanake, shpenzimet kapitale e tjera. Ka shpenzime që mund të reduktohen dhe është mirë që secila drejtori i ka shpenzimet e veta të lejuara”, theksoi prof. Shabanaj.

**Pjetër Coli**, tha së është normale që opozita ia tërheq vërejtjen pozitës për atë sa iu duken atyre që ka shpenzime të tejkaluara.”Unë propozoj që shpenzimet e telefonave dhe karburanteve të ndahen nëpër drejtori”.

**Dr. Haxhi Ibishi**, këtë raport e hodhi në votim. “Kush është për miratimin e Raportit finansiar për periudhën janar-shtator 2014?”

**Me 17 vota pro dhe me 7 vota kundër, u miratua Raporti finansiar për periudhën janar – shtator 2014.**

**Pika e V-të: Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës për Projekt-rregulloren për transparencë dhe vënia në diskutim publik.**

**Arben Limanaj**, tha se ne e mbështesim këtë iniciativë për hartimin e kësaj Rregulloreje dhe vëniën e saj në diskutim publik.

**Prend Buzhala tha së edhe ne e mbështesim këtë iniciativë për hartimin e kësaj Rregulloreje.”Unë mendoj se qytetari nuk është i mbrojtur, andaj kërkon qasje në dokumente zyrtare”, shtoi prof. Buzhala.**

**Dr. Haxhi Ibishi e hodhi në votim iniciativën për hartimin e kësaj Rregulloreje dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë votuan PRO miratimit të kësaj Rregulloreje.**

**Pika e VI-të: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Komisionit Komunal për të zhdukurit e cila kërkon që data e 4 Prillit të jetë ditë zyrtare për të zhdukurit.**

**Zeqir Morina**, sqaroi çështjen. “Komuna jonë ka qenë më e goditura në këtë çështje, andaj këtë propozim për zyrtarizimin e kësaj date duhet ta mbështesim”, shtoi drejtori Morina.

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha së na nevojitet që të marrim një vendim që e zyrtarizon 4 Prillin si ditë zyrtare.

**Tunë Dedaj**, tha se unë mendoj së për këtë është bërë një vonesë e madhe, dhe mbështesë këtë kërkesë.

**Dr. Haxhi Ibishi**, e hodhi këtë kërkesë në votim, kush është pro?

**Të gjithë anëtarët e Kuvendit ishin PRO dhe kjo kërkesë për zyrtarizimin e datës së 4 Prillit U MIRATUA.**

**Pika e VII-te: Njoftim me përgatitjen e caktimit të orarit kalendarik të punës së Kuvendit dh Komiteteve dhe planifikimin punës për vitin 2015 (për seancën e dhjetorit).**

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha se ky është vetëm një njoftim me orarin kalendarik dhe planifikimin e punës së Kuvendit dhe të komiteteve për vitin 2015 që duhet të përgatitet për seancën e dhjetorit.

**Pika e VIII-të: Të ndryshme.**

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha se në bazë Udhëzimit Administrativ ne duhet t’i reformojmë dy Komitetet obligative të Kuvendit me përfaqësim gjinor.”Unë paraprakisht do e zhvilloj një takim me shefat e Grupeve parlamentare dhe besoj se do të mermi vesh për këtë çështje”.

**Ndue Shabanaj**, kërkoi nga kryesuesi që para Kuvendit ta paraqes një shqetësim të madh të tij.

**Dr. Haxhi Ibishi** tha së kjo çështje nuk ka hyrë në rend të ditës.

**Ndue Shabanaj**, doli në foltore dhe tha se shqetësimi im ka të bëjë me një aktivitet që është zhvilluar nga Lëvizja Vetëvendosje, gjegjësisht me veprimet e anëtarit të Kuvendit nga radhët e kësaj Lëvizjeje, z. Skënder Merturi që ka të bëjë me një votim për ndërtime të larta dhe tërë mllefin dhe akuzat ndaj pushteti komunal e adreson ndaj meje dhe familjes sime. “Këto propaganda dhe antifushatë kundër meje më kanë qitur në pozitë të palakmueshme. Unë nuk e kuptoj si mund të merret një angazhim për denigrim ndaj një personi dhe familjes së tij pa asnjë arsy. Atë ditë ka qenë ditë tregu dhe kur kam kaluar andej me ka pa Skënderi dhe i ka bërë thirrje masës “kryqëzoheni këtë njeri, ai është”, konstatoi ndër të tjera anëtarë Shabanaj.

**Dr. Haxhi Ibishi**, tha së kemi kaluar nëpër shumë sfida të ndryshme dhe se raportet tona kolegiale janë të shenjta.”Unë nuk kam dëshirë me e hap këtë debat”, shtoi Kryesuesi.

**Halil Desku**, tha së pasi që kërkesa e Ndout nuk ka hyrë me kohë në këtë pikë të rendit të ditës mendoj se nuk është mirë të hapet debat.

**Fadil Gashi**, ju drejtua Kryesuesit: Nuk bërë mirë që e lejove hapjen e këtij debati, sepse problemet e rrugës u futën në seancë.

**Prend Buzhala** tha se kjo është një praktikë jo e mirë e Kuvendit. “Ne kur kemi propozime për komisione hetimore janë refuzuar, për të ndjerin Nikollë Shabanaj unë kamë shkruar me respektin më të madh”.

**Skënder Merturi**, tha se nuk kamë asgjë personale ndaj Ndou Shabanajt, ky ka qene një aktivitet yni për konflikt interesit dhe nuk ka qenë qëllimi për ta degraduar askënd.

**Tunë Dedaj**, tha se unë kur e kam parë atë shkresë kam qenë shumë i shqetësuar.

**Pjetër Coli**, tha se tani na doli një sihariq i keq.”Unë kam përjetuar debate të ashpra, por ato debate kanë qenë me efekt. Unë mendoj se kjo nuk është aspak në rregull, sepse nuk ka vetëm Ndou banesë aty, e pastaj pse po përmenden ngjyrat fetare?”- shtoi anëtarë Coli.

**Halil Desku**, tha se duhet të jemi sa më të kujdeshëm në fjalimet tona dhe së mënyra e performimit të “Vetëvendosjes” është gabim dhe, a duhet të informohet publiku me performime të tillë? Unë e lus anëtarin e këtij Kuvendi, z. Skënder Merturi, që të këtë qasje pozitive dhe të jetë i kujdeshëm për veprimet e tij”, konstatoi prof. Desku.

Qamile Qitaku tha se unë solidarizohem me shqetësimin e Ndout."Ne në seancën e VIII -te të Kuvendit kemi marrë vendim për rrënimet e objekteve të vjetra dhe ndërtimin objekteve të larta. Unë nuk e di çka ka të keqe këtu", shtoi anëtarja Qitaku.

Me kaq mbledhja e Kuvendit të Komunës përfundoi punën në orën 12:30.

Procesmbajtësi,  
Beqir Gashi



Kryesuesi i Kuvendit,  
Dr. Haxhi Ibishi